



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2913/7 prot.

Datë 26.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**

**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E  
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT  
NGRIHEN PRETENDIME**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK dhe operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, me afat 24 muaj”, me nr REF-75817-07-24-2023 me objekt: loti 2: “Materiale kancelarie të tjera zyre” me fond limit 3,716,833.16 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK, me NIPT: K21605003M Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godinë 3 katëshe, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK Adresa: Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndertese 4 kate, me siperfaqe truall 1’000 m2 dhe siperfaqe ndertese 330 m2, Durres, Spitalle.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

Në datën 22.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3639 dhe me nr. 2913/2023 protokoli datë 22.11.2023 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, me afat 24 muaj”, me nr REF- 75817-07-24-2023 me objekt: loti 2: “Materiale kancelarie të tjera zyre” me fond limit 3,716,833.16 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 09.10.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK dhe operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”*.

-Komisioni i prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimesi pretendon se operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK nuk i plotëson:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Si dhe ngrihen pretendime se oferta e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK është ofertë anomalisht e ulët.

-Komisioni i prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimesi pretendon se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK nuk i plotëson:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.4.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Si dhe ngrihen pretendime se oferta e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK është ofertë anomalisht e ulët.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 26.12.2023.

(Korrigjuar me Vendimin nr. 1350/2023, datë 22.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.).

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Anila Malaj</b>	<b>Kreshnik Tërnova</b>
	<b>Kryetar</b>	
	<b>Jonaid Myzyri</b>	